



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 14/ 2011

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga, Ferit Osmani kryesues, Rafet Haxhaj dhe Hasan Shala, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosja (LVV) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër disa personave, për shkak të kërcënimit gjatë procesit të votimit, në seancën e panelit të mbajtur me 13.01.2011, mori këtë:

V E N D I M

REUZOHEN si të pabazuar ankesat e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosja (LVV).

A r s y e t i m

PZAP ka pranuar dy ankesa me datë 09.01.2011, nga LVV në të cilat theksohet se:

A nr. 14- me datën 09.01.2011 në Drenas shkollën fillore ish-Bashkimi 0301x nuk janë lënë vezhguesit e LVV të qendrojnë brenda, madje janë kërcënuar duke ju thënë që nuk keni nevojë të vini ketu sepse nuk jeni nga kjo komunë. Në këtë venvotim nuk kemi komisioner, ekemi vetëm 1 komisioner rezerv mirpo edhe pas nënshtrimit të të gjitha procedurave që ai të hyjë në venvotim nuk e kanë lënë të hyjë. Emri i komisionerit të LVV është Bekim Shala. Parashtruesi i ankesës ka përmendur si deshmitar emrat e Mehdi Gashit, Arianit Sadiku, Armend Rexhepi, Musa Miftari, Abedin Selimi, Jeton Morina.

A nr. 32- me datën 09.01.2011 në QV 0301x në shkollën fillore Bashkimi në Drenas nga ora 10:00- 10:30 menaxheri i kësaj QV Rrahim Muleta pa arsye dhe me forcë ka nxjerrur nga kjo qender vezhguesit e LVV Bislim Bislimaj, Jeton Rrustemi, Burim Azemi, Jakup Demiri dhe Shpend Hasani. E gjithë kjo ka ndodhur me qëllim të manipulimit të vullnetit të lirë të qytetarëve, dhe pas insistimit të vezhguesit nderkombëtar Aleks Anderson të cilin e ka njoftuar LVV-ja këta vezhgues janë kthyer në vendin e vetë. LVV-ja në Drenas në lidhje me këtë prej orës 15:00 ka tentuar disa here të dergojë njoftim KKZ-ës në Drenas për largimin e vezhguesve të tane, por Bela Shehu shef i KKZ-ës është paraqitur në telefon dhe ka thënë se sot nuk do të na pranojë asnjë ankesë.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur si deshmi njoftimin dërguar në KKZ.

Ne raportin e policisë me Nr. reference SPG/OP/11, te dates 11.01.2011 te lëshuar nga togeri policor Fehmi Hoti, lënda “Njoftim lidhur me QV 0301/E në Drenas” theksohet se : “ në QV 0301/E në SH.F Rasim Kiqina ne Drenas, sipas planit operativ ne nderrimin e paradites kanë qenë të caktuar 4 zyrtaret policore

1. Milaim Rukiqi #6239,
2. Fazile Ahmeti #7165,
3. Mirsie Abazi #4012 dhe
4. Kadri Bytiqi #0586

Në raportin e z. Pol Milaim Rukiqit #6239 , ceket se ne kete QV gjate kohes sa ka zgjatur procesi zgjedhor nuk ka verejtur ndonje parregullsi, si dhe nuk ka pranuar ndonje ankese nga pergjegjsit ne kete QV ose nga ndonje vezhgues apo qytetarë. Poashtu sipas raportit te policise edhe ne radiologun Radiobazes se SP Drenas, nuk është pranuar ndonje informat apo ankese në lidhje me kete QV në fjalë

Neni 118 paragrafi 1 i LZP-së, parasheh:

118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 3 paragrafi 6 pika (c) dhe neni 6 paragrafi 3 parashohin si vijon:

3.6 (c) hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit.

6.3 Me qëllim të lehtësimit të shqyrtimit të ankesave, Kryesuesi i Panelit mund të vendos ta bëjë bashkimin e ankesave që përmbajnë në vete çështje të ngjashme, paneli vendim- marrës i trajton ato ankesa sikurse të ishin një ankesë.

PZAP-i vlerësoi se kemi te bëjmë me dy raste te njëjta dhe pasi shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

- ankesat janë te pabazuara.

Pretendimet nga parashtruesi i ankesës janë të pabazuara për shkakun se nuk është ofruar asnjë dëshmi apo prova të mjaftueshme për të besuar se kanë ndodhur shkeljet e pretenduar. Ky fakt konfirmohet edhe përmes raportit të policisë me Nr. reference SPG/OP/11, te dates 11.01.2011 ne te cilin theksohet se ne QV 0301 gjat procesit te zgjedhor nuk pasur asnjë problem sigurie PZAP-i duke u bazuar në arsyet e cekuara më lartë e po ashtu në pajtim më dispozitat e cituara ligjore si dhe në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 14/2011 më datën 13.01.2011.

Kryesuesi i Panelit

Ferit Osmani

